



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prillogat: Përmirësimi Më i Dërguar				29.12.2015 v.god.	
Nr. Organi	Numri i Aktit	Titulli	Vlera		
01-01/165			Vendos		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr. 28/2008, nenit 2 paragrafi 3, neni 8 të Ligjit për financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/2008 dhe nenit 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 24.12.2015 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR PEZULLIMIN E PËRKOHËSHËM TË NENIT 21, NENIT 13 PIKA 13.6 DHE NENIT 41 TË RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1

Me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vitisë, Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON Vendim për pezullim – lirim nga pagesa e taksës komunale për të gjitha subjektet afariste të Komunës së Vitisë të parapara në nenin 21, nenit 13 pika 13.6 dhe nenit 41 të Rregullores komunale për taksa ngarkesa dhe gjoja duke filluar prej 01.01.2016 deri më 31.12.2016.

Neni 2

Obligimet e pa paguara të subjekteve afariste sipas nenit 21, dhe nenit 13 pika 13.6 të Rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoja deri më 31.12.2011 nuk shlyhen por pezullohen për pagesë deri më 31.12.2016.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. MAPL-së
2. Shërbimit të Kuvendit,
3. Drejtorisë për Financa,
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

